

**KONFERENCA E NJËMBËDHJETË RRJETUESE PËR ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR**

Organizatori: Komisioni Ndërkombëtarë për Personat e Zhdukur (ICMP)  
Në bashkëpunim me Shoqatat e Familjeve të Personave të Zhdukur

**Hotel M, Beograd, Republika e Serbisë  
28-30, nëntorë 2008**

**KONKLuzionet**

Anëtarët e shoqatave familjare të personave të zhdukur, shprehin pakënaqsinë e tyre me rezultatet e arritura në procesin e kërkimit të personave të zhdukur dhe kërkojnë që të ndërmerren hapat e poshtshënuar për të përmirësuar procesin:

1. Ne kërkojmë që vendet e rajonit të ratifikojnë Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, dhe të themelojnë mekanizmat të cilët sigurojnë implementimin e kësaj Konvente;
2. Kërkojmë nga të gjitha autoritetet përgjegjëse në rajon, që të nënshkruajnë marrëveshje bilaterale ndërkombëtare për shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunim në procesin e kërkimit të personave të zhdukur;
3. Ne kërkojmë nga zyrat e prokurorëve të të gjitha vendeve në rajon dhe nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë që të kërkojnë mbledhjen e informatave gjatë procesit hetues, për vendndodhjen e varrezave dhe rrethanat e zhdukjes në mënyrë parimore duke intervistuar të dyshimtit ose dëshmitarët në rastet e krimeve të luftës;
4. Ne kërkojmë plotsimin e legjislacionit në vendet e rajonit, që të theksohet se zhvendosja ose ndërhyrja në vendvarreza për ti fshehur ato, të trajtohet si vepër penale;
5. Ne kërkojmë provizione për financim të duhur dhe burime të ekspertëve për zyrat e prokurorit të cilat bëjnë përndjekjen e krimeve të luftës dhe krijimin e mekanizmave efektiv për mbrojtjen e dëshmitarëve;
6. Ne kërkojmë nga vendet e rajonit që të marrin masa efikase për të ndërmarrë hetime të paanshme të të gjitha rasteve të zhdukjes, të bëjnë përndjekjen dhe dënimin e kryesve të veprave pavarësisht përkatsisë së tyre etnike dhe të sigurojnë trajtim të duhur të të drejtave të familjeve të personave të zhdukur, duke përfshirë të drejtën për reparacion apo kompensim;
7. Ne kërkojmë që të bëhen procedimet në B dhe H, në mënyrë që të vlerësohet ligjshmëria e legjislacionit i cili rregullon të drejtat e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur në rastet kur ato nuk janë në pajtueshmëri me kushtetutën;
8. Ne kërkojmë implementimin e vendimit të Odës për të drejtat e njeriut dhe Gjykatës Kushtetuese të B dhe H, në lidhje me çështjen e personave të zhdukur dhe të drejtat e familjeve të personave të zhdukur;
9. Ne kërkojmë nga komisionet qeveritare për persona të zhdukur dhe institucioneve tjera qeveritare që ti japin përparsi absolute zhvarrimeve të mbetjeve mortore të cilat janë nën rrezik dhe varrezave të njohura në rajon, si dhe rizhvarrimet e NN varrezave;

10. Nëse dokumentat dhe faktet tjera të institucioneve përgjegjëse sugjerojnë se ka nevojë për verifikime shtesë të identitetit të personave më herët të identifikuar, ne kërkojmë nga institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin hapat e nevojshëm duke përfshirë këtu edhe përdorimin e analizës së ADN-së;
11. Kërkojmë nga institucionet përgjegjëse të përfshira në procesin e kërkimit të personave të zhdukur, që të intensifikojnë aktivitetet e tyre dhe mbi të gjitha ne këmbëngulim që zyrat e prokurorisë dhe gjykatat të rrisin aktivitetet e tyre në procedimin e të gjithë të dyshuarve për krime lufte të kryera në rajon;
12. Kërkojmë nga institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin hetime për fatin e personave të zhdukur të cilët kanë qenë të regjistruar nga KNKK si të burgosur, dhe zhdukja e mëpasme e tyre është e lidhur me përgjegjësinë e institucioneve qeveritare;
13. Ne rekomandojmë që projekti i përbashkët i identifikimit i bazuar në ADN, në mes të Ministrisë për Familje, çështje të Veteranëve dhe Solidaritetit ndër Gjenerata të Republikës së Kroacisë dhe Komisionit Ndërkombëtarë për Persona të Zhdukur (ICMP) të përmirësohet në harmoni me ligjet e Republikës së Kroacisë dhe procedurat e ICMP-së që në atë mënyrë të përshpejtohet procesi i identifikimit;
14. Kërkojmë që ICMP të organizojë takim në mes të komisioneve qeveritare për persona të zhdukur të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Serbisë me përfaqësuesit e shoqatave familjare të personave të zhdukur nga Republika e Kroacisë dhe Republika e Serbisë, në pranverë të vitit 2009;
15. Kërkojmë që ICMP, urgjentisht të organizojë takim në mes të përfaqësuesve të shoqatave Shqiptare dhe Serbe për persona të zhdukur dhe institucioneve relevante të përfshira në procesin e kërkimit të personave të zhdukur më Kosovë me qëllim të gjetjes së fakteve për fatin e personave të zhdukur nga ky rajon;
16. Kërkojmë krijimin e mekanizmave shtesë me qëllim të mbledhjes së informacioneve për vendndodhjen e varrezave dhe që vendet e rajonit të kërkojnë përkrahje financiare nga institucionet e Bashkimit Europian për funksionimin e plotë të këtyre mekanizmave;
17. Kërkojmë shkëmbinin e plotë të të gjithë dokumentave dhe informatave në mes të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Serbisë, pa asnjë vonesë, dhe që institucionet përgjegjëse për kërkimin e personave të zhdukur nga këto shtetet të organizojnë takime të rregullta në mënyrë që të shkëmbehen informatat dhe të përmirësohet bashkpunimi;
18. Kërkojmë kalimin e ligjit për persona të zhdukur në Republikën e Serbisë dhe Kosovë si dhe që Republika e Kroacisë të plotësojë ligjin ekzistues i cili rregullon të drejtat e viktimave civile të luftës për mëmëdheun;
19. Kërkojmë që shoqatat e familjeve të personave të zhdukur të shpallen me interes të veçantë publik dhe t'ju ofrohet status special si dhe financim adekuat i aktiviteteve të tyre;
20. Këto konkluzione do tu dërgohen qeverive dhe kuvendeve të vendeve të rajonit dhe institucioneve tjera të përfshira në procesin e kërkimit të personave të zhdukur si dhe mediave dhe e ngarkojmë Bordin Kordinues Rajonal që të përcjellë implementimin.